

**UDHËZIM**  
**Nr. 37, datë 31.12.2012**

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE NË ZBATIM TË KRITEREVE, MASËS SË  
FINANCIMIT DHE PROCEDURAVE QË NDIQEN PËR PËRFITIMIN E FONDIT TË  
EKSELENCËS NGA STUDENTËT DHE SHKENCËTARËT E SHKËLQYER**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” dhe të vendimit nr. 875, datë 19.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për fondin e ekselencës, për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer”,

**UDHËZOJ:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Studentët dhe shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer, mund të përfitojnë nga Fondi i Ekselencës të akorduar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH):

a) bursa të posaçme për studentë që kryejnë studimet e plota të doktoratës ose një pjesë të tyre jashtë shtetit në një nga 15 universitetet më të mira të botës në shkencat shoqërore, të artit dhe sportit; në një nga 50 universitetet më të mira të botës në shkencën e matematikës, shkenca natyrore, shkenca teknike, teknologji, shkenca të edukimit dhe shkenca të jetës, sipas renditjes së përcaktuar nga *Times Higher Education* “Renditja Botërore e Universiteteve”, për vitin më të fundit; si dhe në një nga universitetet e mirënjohura të botës për studimet në albanologji, pasi kanë përfunduar ciklin e parë e të dytë të studimeve universitare;

b) bursa të posaçme për studentë që ndjekin studime “Bachelor” ose “Master” në një nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së përcaktuar nga *Times Higher Education* “Renditja Botërore e Universiteteve”, në vitin më të fundit, për njërin nga dy ciklet e studimit në matematikë, shkenca natyrore, shkenca të edukimit, shkenca teknike, teknologji, shkenca të jetës, artit dhe sportit, si dhe për ata që janë pranuar në një nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së përcaktuar nga *Times Higher Education* “Renditja Botërore e Universiteteve”, në vitin më të fundit, për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit në shkencat shoqërore dhe kanë përfituar një pjesë të financimit nga universiteti pritës, për çdo vit akademik.

2. Mbështetja financiare e mësipërme mund të jepet:

a) në formë të plotë;

b) në formë të pjesshme;

c) me bashkëfinancim ndërmjet MASH dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendase ose të huaja.

3. Për përzgjedhjen, vlerësimin fillestar të kandidatëve dhe ecurinë e tyre gjatë studimeve, Ministri i Arsimit dhe Shkencës formon dy komisione: një për shkencat shoqërore dhe një tjetër, për shkencat natyrore dhe teknike. Secili komision përbëhet nga pesë anëtarë, profesorë të universiteteve në fushat përkatëse, që kanë së paku gradën shkencore “Doktor”, si dhe një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Komisionet kryesohen nga titullarë të MASH.

4. Për administrimin e fondit të ekselencës, Ministri krijon një Sekretari Teknike të Programit (STP), të përbërë nga personeli administrativ i MASH-it. STP përgjigjet për zbatimin e procedurave dhe kontratave të Fondit të Ekselencës dhe mbështet teknikisht punën e komisioneve përzgjedhëse (KP).

**KREU II**  
**KRITERE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE TË POSAÇME PËR STUDENTË QË KRYEJNË**

## STUDIMET E DOKTORATËS JASHTË VENDIT

1. Bursa të posaçme, për studentët që kryejnë studimet e doktoratës jashtë vendit jepen kur studentët plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) Janë pranuar në një institucion të arsimit të lartë të huaj për studimet e doktoratës, sipas përcaktimeve të pikës 1/a të kreut të parë të këtij udhëzimi, sipas sistemit tradicional ose me bashkudhëheqje (“Sandwich” ose “Cotutelle”).

i) Sistemi tradicional i studimeve të doktoratës nënkupton që doktorata realizohet dhe provimi i saj jepet në institucionin e arsimit të lartë të huaj. Kandidati qëndron gjithë kohën ose një pjesë të kohës së studimeve të doktoratës në institucionin e huaj të arsimit të lartë.

ii) Sistemi me bashkudhëheqje i doktoratës nënkupton që kandidati/ja drejtohet nga dy udhëheqës shkencorë, përfaqësues të institucioneve përkatëse të arsimit të lartë. Kandidati mund të jetë i regjistruar në njërin ose në të dyja universitetet, ndërsa provimi ose mbrojtja e doktoratës bëhet si rregull në një universitet të vendit. Në këtë rast, bashkudhëheqësi nga institucioni i arsimit të lartë i huaj duhet të ketë së paku gradën shkencore “Doktor” (PhD), botime të njohura ndërkombëtare me faktor impakti dhe një përvojë pune në mësimdhënie prej së paku 5 vjetësh; në doktoratën me bashkudhëheqje, udhëheqësi shkencor nga institucioni i arsimit të lartë të vendit, duhet të ketë gradën dhe titullin akademik sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

b) Kanë arritur notë mesatare mbi 9 në shkencat natyrore, inxhinierike e shkenca të jetës dhe mbi 9.5 në shkencat ekonomike e shoqërore për studimet e kryera brenda vendit; ose, përkatësisht, mbi 8 (e barasvlershme me vlerësimin B në sistemin anglo-sakson), në shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës dhe mbi 8.5 (e barasvlershme me vlerësimin B+ në sistemin anglo-sakson) në shkencat ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit në secilin cikël studimi;

c) Janë pranuar në një universitet të huaj për studimet e doktoratës, pa pagesë për tarifa studimesh (*tuition fee*) dhe nuk marrin pagë ose shpërblim për punën kërkimore apo mësimore që bëjnë gjatë këtyre studimeve në universitetin pritës;

d) Kanë përgatitur një projekt për kërkim gjatë studimeve të doktoratës jashtë shtetit dhe të gjitha shpenzimet e projektit kërkimor janë marrë përsipër nga universiteti pritës;

e) Pranojnë të punojnë në Shqipëri, për së paku 3 vjet, pas përfundimit të studimeve të doktoratës jashtë shtetit;

f) Nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar dhe nuk kanë të ardhura personale dhe të familjarëve të tyre prindërit, adoptuesit, bashkëshortët, fëmijët dhe i adoptuari deri në moshën 18-vjeçare tetëmbëdhjetëvjeçare mbi 200 000 (dyqind mijë) lekë në muaj. Kjo vërtetohet, për çdo kandidat, përmes një deklarimi të punëdhënësit kur është i punësuar, një deklaratë personale dhe familjare të kandidatit, si dhe çdo dokument tjetër zyrtar.

2. Mbështetja financiare në formën e bursës së posaçme, sipas pikës 1 kreu II jepet për një periudhë deri 30 muaj për studimet e ciklit të tretë, doktoratat që realizohen tërësisht në universitetet e huaja, dhe deri 9 muaj për ato të sistemit me bashkudhëheqje, deri në masën e vlerësuar nga KP. Bursa e posaçme përbëhet nga:

a) Shpenzimet e jetesës, në masën jo më shumë se 1000 euro/muaj;

b) Shpenzimet e udhëtimit, në masën e përcaktuar në varësi të vendit/rajonit në fjalë, kohëzgjatjes së qëndrimit dhe formës së studimeve të doktoratës:

i) forma tradicionale: 350 €/Europë ose 850 €/të tjera

ii) forma *Sandwich*: 500 €/Europë ose 1000 €/të tjera

c) Taksën e regjistrimit për studimet e doktoratës, por jo taksën vjetore të shkollimit (*tuition fee*);

d) Shpenzime të udhëtimit të udhëheqësve shkencorë të institucionit të huaj të arsimit të lartë që drejtojnë doktorata me bashkudhëheqje.

3. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe ndjek hapat dhe fazat e mëposhtme:

a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall programin për përzgjedhjen e kandidatëve sipas fushave, dokumentet dhe afatet e dorëzimit të tyre.

b) STP, pasi bën verifikimin e dokumentacionit, i jep informacion ministrit për numrin e aplikantëve dhe fushat ku ata kanë aplikuar.

c) STP njofton me *e-mail* kandidatët për mbërritjen e dokumenteve të kërkuara dhe dokumentet e tjera që mund të duhen shtesë.

### 3.1 Faza e shqyrtimit të dokumentacionit:

a) STP verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në këtë udhëzim. Kandidatët që kanë mangësi në dokumentacion përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.

b) STP njofton me *e-mail* kandidatët për mbërritjen e dokumenteve të aplikimit.

### 3.2 Faza e përzgjedhjes paraprake:

a) KP-të bëjnë një vlerësim për plotësimin e kriterëve nga kandidatët. Mbas plotësimit të kriterëve, KP-të kryejnë klasifikimin e kandidatëve përmes një sistemi pikëzimi, për fazën e intervistës.

b) STP njofton përmes *e-mail*-it kandidatët që janë përzgjedhur për t'u intervistuar, datat dhe vendin e zhvillimit të intervistave.

c) KP-të zhvillojnë intervistat brenda 2 muajve nga mbyllja e aplikimit.

### 3.3 Faza e përzgjedhjes përfundimtare:

a) KP në bashkëpunim me STP, mbi bazën e rezultateve të vlerësimit për plotësimin e kriterëve dhe të intervistës, bëjnë klasifikimin përfundimtar të kandidatëve. Procesverbalet e mbledhjeve të KP-së, ku pasqyrohen dhe vendimet përfundimtare, nënshkruhen nga anëtarët e KP-së.

b) Vendimet përfundimtare të KP-së i dërgohen Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratimin e kandidatëve fitues.

### 3.4 Shpallja e kandidatëve fitues:

a) Kandidatët njoftohen nëpërmjet *e-mail*-it, për klasifikimin e tyre, fitues ose jofitues.

b) STP njofton me shkrim udhëheqësin/it shkencor dhe titullarët e institucionit/eve pritëse ku kandidati fitues kryen studimet e doktoratës.

### 3.5 Lidhja e marrëveshjes:

a) MASH shpall afatin për lidhjen e aktmarrëveshjes për vitin e parë të studimeve.

b) Kandidatët fitues nënshkruajnë aktmarrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

c) STP i dërgon aktmarrëveshjen për zbatim sektorit të financës në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, që është përgjegjëse për veprimet financiare me përfituesit e bursës.

4. Vlerësimi i ndërmjetëm i rezultateve të studimeve dhe përsëritja e aktmarrëveshjes për mbështetje financiare, rregullohet si më poshtë:

a) Përfituesit e bursës dorëzojnë, deri më 30 qershor të çdo viti kalendarik, raporte të ndërmjetme të studimeve. Raporti i ndërmjetëm ka strukturë ku paraqiten:

i) periudha e qëndrimit në universitetin e huaj, e konfirmuar nga udhëheqësi shkencor dhe autoritetet drejtuese (dekan/rektor) të institucionit të arsimit të lartë pritës;

ii) puna kërkimore e kryer;

iii) ciklet e leksioneve të ndjekura dhe rezultati i arritur;

iv) artikuj të botuar, referate të mbajtura, ku të jetë përmendur se janë realizuar me mbështetjen financiare nga Programi i Fondit të Ekselencës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës;

v) plani i detyruar i studimeve për vitin pasardhës.

Raporti i ndërmjetëm i bursistëve nënshkruhet nga udhëheqësi/t shkencor/ë. Kandidatët që kanë përfituar bursë për studime të doktoratës sipas sistemit "Sandwich" dorëzojnë edhe një dokument, të lëshuar nga institucioni ku është i punësuar, në të cilin saktësohet periudha kohore e lejuar për të vijuar studimet në institucionin partner jashtë vendit.

b) KP, brenda 30 ditëve, shqyrton raportet e ndërmjetme, mund të intervistojë doktorantët dhe i rekomandon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës vazhdimin ose ndërprerjen e mbështetjes financiare;

c) STP, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, njofton kandidatët, të cilët përfitojnë mbështetje të mëtejshme financiare, për nënshkrimin e aktmarrëveshjes.

### 5. Përfundimi i studimeve të doktoratës:

a) Me përfundimin e afatit të mbështetjes, të miratuar në aktmarrëveshje, përfundon edhe mbështetja financiare në kuadër të këtij programi.

b) Përfituesit e kësaj burse dorëzojnë në STP një kopje të diplomës së fituar, të disertacionit, të monografive, librave apo artikujve të botuar, si dhe të referateve të mbajtura gjatë kohës që kanë qenë të përfshirë në programin e fondit të ekselencës.

c) Në disertacion duhet të përmendet se studimet e doktoratës janë realizuar me mbështetjen financiare nga Programi i Fondit të Ekselencës i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

#### 6. Programi “Alumni - Ekselencat”

MASH do të nxisë që të gjithë përfituesit nga ky program, pas përfundimit të studimeve të doktoratës, të bëhen anëtarë të Programit “Alumni - Ekselencat”, i cili synon të ruajë dhe të zhvillojë më tej kontaktet ndërmjet MASH dhe përfituesve nga fondi i ekselencës.

### KREU III

#### BURSA TË POSAÇME PËR STUDENTË, QË NDJEKIN STUDIMET UNIVERSITARE CIKLIN E PARË (*BACHELOR*) DHE CIKLIN E DYTË (*MASTER*)

1. Përfitojnë mbështetje financiare, në formën e bursës së studimit, studentët që ndjekin jashtë vendit ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve universitare, nëse:

a) janë pranuar në një nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së përcaktuar nga *Times Higher Education* “Renditja Botërore e Universiteteve”, në vitin më të fundit, për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit në matematikë, shkencë natyrore, të edukimit, teknike, teknologji, shkencë të jetës, artit dhe sportit;

b) janë pranuar në një nga 15 universitetet më të mira të botës sipas renditjes së përcaktuar nga *Times Higher Education* “Renditja Botërore e Universiteteve”, në vitin më të fundit, për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit në shkencat shoqërore dhe kanë përfitur një pjesë të financimit nga universiteti pritës;

c) Pranojnë të punojnë, së paku 3 (tre) vjet në Shqipëri, pas përfundimit të ciklit përkatës të studimeve, për të cilin përfitojnë bursën, ose pas përfundimit të të gjithë ciklit të studimeve, nëse kandidati përfitues vijon studimet në ciklet më të larta universitare;

d) Nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar dhe nuk kanë të ardhura personale dhe të familjarëve të tyre prindërit, adoptuesit, bashkëshortët, fëmijët dhe i adoptuari deri në moshën 18-vjeçare (tetëmbëdhjetëvjeçare) mbi 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë në muaj. Kjo vërtetohet përmes një deklarimi të punëdhënësit kur kandidati është i punësuar, një deklaratë personale dhe familjare të kandidatit, si dhe çdo dokument tjetër zyrtar.

##### 1.1 Cikli i parë

Studentët që aplikojnë për ciklin e parë të studimeve, duhet të kenë përfunduar studimet parauniversitare me mesatare mbi 9 të të gjitha viteve të shkollës së mesme ose ekuivalente për ata që kanë përfunduar këto studime jashtë shtetit.

Studentët që aplikojnë për t’u mbështetur financiarisht, për herë të parë, me bursë nga fondi i ekselencës, për vitin e dytë ose të tretë të studimeve të ciklit të parë *bachelor* duhet të kenë arritur mesataren e notave mbi 8 (vlerësimin “B” në sistemin anglo-sakson) për vitet akademike paraardhëse.

##### 1.2 Cikli i dytë

Studentët që aplikojnë për ciklin e dytë të studimeve, duhet të kenë përfunduar studimet e ciklit të parë me notë mesatare mbi 9 në shkencat natyrore, inxhinierike e shkencë të jetës dhe mbi 9.5 në shkencat ekonomike e shoqërore për studimet e kryera brenda vendit, ose, përkatësisht, mbi 8 (e barasvlershme me vlerësimin “B” në sistemin anglo-sakson), në shkencat natyrore, inxhinierike e të jetës, dhe mbi 8.5 (e barasvlershme me vlerësimin “B+” në sistemin anglo-sakson), në shkencat ekonomike e shoqërore, për studimet e kryera jashtë shtetit.

Studentët që aplikojnë për t’u mbështetur financiarisht për herë të parë me bursë nga fondi i ekselencës, që të mund të përfitojnë për vitin e dytë të studimeve master, duhet të kenë arritur mesataren e notave mbi 8 (vlerësimin “B” në sistemin anglo-sakson) në vitin akademik paraardhës.

2. Mbështetja financiare në formën e bursës së posaçme, sipas pikës 1 kreu III përfshin mbulimin e:

a) shpenzimeve të parashikuara dhe të detajuara nga universiteti pritës, ku studenti është pranuar, deri në masën e vlerësuar nga KP;

b) shpenzimeve të udhëtimit, në masën 350 €/Europë, 850 €/për vendet e tjera.

3. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe ndjek hapat dhe fazat e mëposhtme:

a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall programin për përzgjedhjen e kandidatëve sipas fushave, dokumentet dhe afatet e dorëzimit të tyre.

b) STP, pasi bën verifikimin e dokumentacionit, i jep informacion ministrit për numrin e aplikantëve dhe fushat ku ata kanë aplikuar.

c) STP njofton me *e-mail*, kandidatët për mbërritjen e dokumenteve të kërkuara dhe dokumentet e tjera shtesë që mund të duhen.

3.1 Faza e shqyrtimit të dokumentacionit:

a) STP verifikon plotësimin e dosjes me dokumentet e kërkuara në këtë udhëzim. Kandidatët që kanë mangësi në dokumentacion përjashtohen nga përzgjedhja në fazat e mëtejshme.

b) STP njofton me *e-mail*, kandidatët për mbërritjen e dokumenteve të aplikimit.

3.2 Faza e përzgjedhjes paraprake:

a) KP-të bëjnë një vlerësim për plotësimin e kriterëve nga kandidatët. Mbas plotësimit të kriterëve, KP kryen klasifikimin përmes një sistemi pikëzimi për fazën e intervistës.

b) STP njofton me *e-mail* kandidatët që janë përzgjedhur për t'u intervistuar, për datat dhe vendin e zhvillimit të intervistave.

c) KP-të zhvillojnë intervistat brenda dy muajve nga mbyllja e aplikimit.

3.3 Faza e përzgjedhjes përfundimtare:

a) KP-të në bashkëpunim me STP, mbi bazën e rezultateve të vlerësimit për plotësimin e kriterëve dhe të intervistës, bëjnë klasifikimin përfundimtar të kandidatëve. Procesverbalet e mbledhjeve të KP-së, ku pasqyrohen dhe vendimet përfundimtare, nënshkruhen nga anëtarët e KP-së.

b) Vendimet përfundimtare të KP-së i dërgohen Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për miratimin e kandidatëve fitues.

3.4 Shpallja e kandidatëve fitues:

a) Kandidatët njoftohen me *e-mail*, për klasifikimin e tyre, fitues ose jo fitues.

b) STP njofton me shkrim titullarët e institucionit pritës për kandidatët fitues.

3.5 Lidhja e marrëveshjes:

a) MASH shpall afatin për lidhjen e aktmarrëveshjes për vitin e parë të studimeve.

b) Kandidatët fitues nënshkruajnë aktmarrëveshjen me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

c) STP i dërgon për zbatim aktmarrëveshjen, sektorit të financës në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila është përgjegjëse për veprimet financiare me përfituesit e bursës.

4. Vlerësimi i ndërmjetëm i rezultateve të studimeve dhe përsëritja e aktmarrëveshjes për mbështetje financiare rregullohet si më poshtë:

a) Përfituesit e bursës dorëzojnë pranë STP, deri më 30 qershor të çdo viti kalendarik, dokumentet si më poshtë:

i) vërtetim për periudhën e qëndrimit në universitetin e huaj, e konfirmuar nga autoritetet drejtuese të institucionit të arsimit të lartë pritës;

ii) lista e rezultateve të arritura gjatë vitit akademik të mbështetur me bursë;

iii) plani i detyruar i studimeve për vitin pasardhës.

b) KP-të shqyrtojnë, brenda 30 ditëve, dokumentacionin e depozituar dhe i rekomandojnë Ministrit të Arsimit dhe Shkencës vazhdimin ose ndërprerjen e mbështetjes financiare;

c) STP, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, njofton kandidatët, të cilët përfitojnë mbështetje të mëtejshme financiare, për nënshkrimin e aktmarrëveshjes.

5. Përfundimi i studimeve:

a) Me përfundimin e studimeve, përfundon edhe mbështetja financiare në kuadër të këtij programi.

b) Përfituesit e kësaj burse dorëzojnë në STP një kopje të diplomës *bachelor* apo master, të

shoqëruar me listën e notave, si edhe një kopje të tezës së mbrojtur, kur ka qenë e parashikuar në kurrikulën përkatëse të studimeve.

#### 6. Programi “Alumni – Ekselencat”:

MASH do të nxisë që të gjithë përfituesit nga ky program, pas përfundimit të studimeve *bachelor* ose master, të bëhen anëtarë të programit “Alumni - Ekselencat”, i cili synon të ruajë dhe të zhvillojë më tej kontaktet ndërmjet MASH dhe përfituesve nga fondi i ekselencës.

### KREU IV MASA NDËSHKIMORE

1. Ndërprerja e financimit për bursat e parashikuara në germenat “a”, “b” të pikës 1 të kreut I bëhet në rastet e mëposhtme:

a) Kur studenti ndërpret studimet për më shumë se 1 (një) muaj gjatë vitit akademik përkatës, përveç rasteve kur paraqet raport mjekësor, vërtetuar nga klinikat mjekësore;

b) Kur studenti nuk jep të gjitha provimet apo e përfundon vitin akademik me notën mesatare më të ulët se nota 8 (vlerësimi ndërkombëtar, sistemi anglo-sakson “B”);

c) Kur studenti kërkon vetë ndërprerjen e financimit;

d) Kur studenti përjashtohet nga universiteti;

e) Kur studenti apo shkencëtari ri, që ka përfituar bursë, nuk ka realizuar detyrimet e programit përkatës, si: ndërprerje e studimeve; refuzimi i kthimit për të punuar në Shqipëri.

2. Studentët dhe shkencëtarët e rinj, që kanë përfituar bursë, sipas vendimit nr. 875 datë 19.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për fondin e ekselencës për mbështetjen financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer”, dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës, i ndërpresin ato ose kur pas përfundimit të studimeve, refuzojnë të punojnë në Shqipëri, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e lidhur, detyrohen t’i kthejnë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës shumën e marrë në formë burse.

### KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 24, datë 30.7.2010 “Për përcaktimin e kriterëve, masës dhe procedurave për përfituesit nga fondi i ekselencës për studentët e shkencëtarët e rinj, të shkëlqyer”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

### SHTOJCË I. BURSA TË POSAÇME, PËR STUDENTË, QË KRYEJNË STUDIMET E DOKTORATËS JASHTË VENDIT

Dokumentet që duhet të paraqesë kandidati janë:

1. Kërkesa e kandidatit;

2. Certifikata personale dhe certifikata familjare;
3. Kopja e pasaportës ose letërnjoftimit;
4. Vërtetimi i qendrës së banimit (është e rëndësishme të dihet që personi nuk ka ndërruar shtetësinë dhe nuk është vendosur përgjithmonë jashtë vendit);
5. Vërtetimi i qendrës së punës, kur është në marrëdhënie pune;
6. CV-ja e hollësishme në formë tabelore e kandidatit, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton karrierën profesionale të dhënë në CV;
7. Deklarata për të ardhurat personale dhe familjare, të shoqëruara me vërtetimet përkatëse nga punëdhënësi/it kur është/janë të punësuar, si dhe çdo dokument tjetër zyrtar;
8. Diplomat e noterizuara të studimeve universitare të ciklit të parë dhe të dytë së bashku me aneksin e notave;
9. Letra e pranimit nga departamenti përkatës i institucionit të arsimit të lartë pritës ku të përcaktohet/en supervizori/et nëse procesi i regjistrimit realizohet pas një periudhe të caktuar kohore, si edhe në rastet e studimeve të plota;
10. Deklarata e udhëheqësit ose e bashkudhëheqësit shkencor të institucionit të arsimit të lartë të huaj për pranimin e kandidatit si dhe llojet dhe masat e shpenzimeve që merr përsipër universiteti partner;
- Deklarata e bashkudhëheqësit të një institucioni të arsimit të lartë të vendit që ka të drejtën të zhvillojë studime të doktoratës, që ka pranuar të bashkudhëheqë kandidatin;
11. CV-ja dhe lista e botimeve e udhëheqësit ose bashkudhëheqësit shkencor të institucionit të huaj të arsimit të lartë;
12. Një parashikim i kostos së studimeve, të detajuar sipas zërave kryesorë, si: shpenzime jetese, udhëtimi, tarifa e shkollës etj.
13. Deklarata personale që nuk përfiton ndonjë bursë apo financim tjetër nga shteti shqiptar;
14. Në rast bashkëfinancimi ndërmjet MASH dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendase ose të huaja të paraqitet kopja e noterizuar e dokumentacionit që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendase ose të huaja (përfshijtur ato shtetërore);
15. Projektidea e temës së doktoratës, në të cilën të paraqitet qartësisht objekti kryesor i studimit, metodologjia (në varësi të llojit të disiplinës), literatura kryesore që është përdorur;
16. Deklarata para noterit, më anë të së cilës kandidati pranon të punojë, për së paku 3 vjet në Shqipëri, pas përfundimit të studimeve të doktoratës;
17. Tri rekomandime për cilësitë dhe nivelin e kandidatit (referentët duhet të jenë persona që e njohin mirë kandidatin dhe kanë së paku gradën shkencore “Doktor” ose janë figura të njohura në fushat e shkencës, kulturës, ekonomisë, politikës etj.).

## II. DOKUMENTET PËR BURSA TË POSAÇME PËR STUDENTË, QË NDJEKIN JASHTË SHTETIT CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË

Dokumente që duhet të paraqesë kandidati janë:

1. Kërkesa e kandidatit;
2. Certifikata e lindjes dhe certifikata familjare;
3. Kopja e pasaportës ose e letërnjoftimit;
4. Vërtetimi i qendrës së banimit (është e rëndësishme të dihet që personi nuk ka ndërruar shtetësinë dhe nuk është vendosur përgjithmonë jashtë vendit);
5. CV-ja e hollësishme, e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton të dhënat në CV-së;
6. Deklarata për të ardhurat personale dhe familjare, të shoqëruara me vërtetimet përkatëse nga punëdhënësi;
7. Dëftesa e pjekurisë/diploma e maturës e noterizuar/diploma e studimeve universitare;
8. Letërpranimi nga universiteti/institucioni i huaj që rezulton në listën e 15 universiteteve më të mira të botës, sipas renditjes së përcaktuar nga *Times Higher Education* “Renditja Botërore e Universiteteve”;
9. Një parashikim të detajuar të kostos së studimeve, lëshuar nga universiteti pritës ku do të jepet dhe masa e bursës/mbështetjes financiare që i jepet kandidatit;

10. Deklarata personale që nuk përfiton ndonjë bursë apo financim tjetër nga shteti shqiptar;
11. Në rast bashkëfinancimi ndërmjet MASH dhe organizatave, fondacioneve dhe institucioneve vendase ose të huaja, të paraqitet kopja e noterizuar e dokumentacionit që vërteton marrjen nga kandidati të bursës nga organizatat, fondacionet dhe institucionet vendase ose të huaja (përfshirë ato shtetërore);
12. Deklarata para noterit me anë të së cilës kandidati pranon të punojë, për së paku 3 vjet në Shqipëri, pas përfundimit të studimeve;
13. Tri rekomandime për cilësitë e kandidatit.